



RESU

Transhumance
Resilience and
Utilisation for
Sustainable
Transformation

reinforcesustainability.com

Raport Rekomandimesh



EUROPA
NOSTRA



Alliance internationale
pour la protection
du patrimoine dans
les zones en conflit



European
Heritage
Hub



Co-funded by
the European Union

Thanks to the support of the European Heritage Hub pilot Project co-funded by the European Union and supported by the ALIPH Foundation

AUTORËT

Prof. Zef GJETA

Prof.Asc. Ilirjan BAKIASI

Oljam DERVISHI

Tiranë, Prill 2025

© 2025 nga RESU-Reinforce Sustainability. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

RESU-Reinforce Sustainability

Adresa: Rr. Naim Fashëri, Tiranë

Email: info@reinforcesustainability.com

Website: reinforcesustainability.com

SHËNIM

Ky raport është përgatitur nga Reinforce Sustainability (RESU) në kuadër të projektit “TRUST: Transhumance Resilience and Utilisation for Sustainable Transformation”. Pikëpamjet dhe përfundimet e paraqitura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo opinionet e Europa Nostra, Bashkimit Evropian, Fondacionit ALIPH apo Konsorciumit të European Heritage Hub.

Autorësia e këtij botimi i përket ekskluzivisht RESU-së. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo mënyre, elektronike apo tjetër, pa miratimin paraprak me shkrim nga RESU.

PËRMBATJA

1. Hyrje.....	4
1.1 Qëllimi i raportit.....	4
1.2 Konteksti dhe rëndësia e transhumancës.....	4
1.3 Burimet e rekomandimeve dhe metodologjia e ndjekur.....	5
2. Korniza e Aktorëve dhe Roli i tyre	6
2.1 Aktorët institucionale	6
2.2 Aktorët lokalë dhe komuniteti i barinjve	7
2.3 Roli i Partnereve Kombëtar dhe ndërkombëtarë si dhe shoqërisë civile.	7
3. Analiza SWOT e Transhumancës në Shqipëri	8
4. Rekomandimet Strategjike të Ndara sipas Aktorëve	9
5. Përfundime dhe Hapa të Mëtejshëm	11
5.1 Nevoja për qasje të integruar ndërsektoriale	11
5.3 Nevoja për monitorim dhe reflektim të vazhdueshëm	11

1. Hyrje

1.1 Qëllimi i raportit

Ky raport rekomandimesh është përgatitur në kuadër të projektit “TRUST – Transhumance Resilience and Utilisation for Sustainable Transformation”, si një instrument mbështetës për politikëbërjen dhe ndërhyrjet strategjike që synojnë ruajtjen dhe përshtatjen e praktikës së transhumancës në Shqipëri. Ai bazohet në një proces të gjerë konsultimi dhe grumbullimi të të dhënave që përfshin aktorë institucionalë, praktikues të transhumancës dhe aktorë akademikë.

Gjatë hartimit të këtij raporti, organizata RESU ka zhvilluar dy workshope konsultative me qëllim mbledhjen dhe diskutimin e rekomandimeve:

- Më 28 tetor 2024 u organizua workshopi i parë me barinjtë dhe përfaqësues të akademisë, me temë "Workshop Konsultativ për Hartimin e Raportit të Rekomandimeve për Transhumancën në Shqipëri", ku u trajtuan sfidat praktike të terrenit dhe u mbështet nevoja për ndërhyrje strukturore.
- Më 23 prill 2025 u zhvillua workshopi i dytë institucional, me temë "Workshop Konsultativ Institucional për Hartimin e Raportit të Rekomandimeve për Transhumancën në Shqipëri", ku mori pjesë vetëm Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si institucioni i vetëm që formalizoi një paketë të strukturuar rekomandimesh.

Përmes këtij procesi, ky raport synon të:

Sistematizojë rekomandimet e dala nga aktorët përkatës, veçanërisht ato të Ministrisë së Bujqësisë dhe komunitetit të barinjve;

Paraqesë qasje të diferencuar sipas aktorëve institucionalë dhe fushave ndërhyrëse;

Ofron një kuadër teknik e politik për mbështetjen e praktikës së transhumancës si trashëgimi kulturore, strategji ekologjike dhe mundësi zhvillimi rural të qëndrueshëm.

Ky raport është jo vetëm një reflektim i evidencës shkencore të grumbulluar nga projekti TRUST, por edhe një dokument orientues për institucionet përgjegjëse dhe partnerët zhvillimorë në adresimin e sfidave reale të praktikës së transhumancës në Shqipëri.

1.2 Konteksti dhe rëndësia e transhumancës

Transhumanca në Shqipëri përfaqëson një praktikë tradicionale të lëvizjes sezonale të bagëtive midis kullotave alpine verore dhe ultësirave dimërore, e trashëguar brez pas brezi nga komunitetet baritore në veri dhe jug të vendit. Përtej funksionit të saj ekonomik, kjo praktikë përfaqëson një sistem kompleks menaxhimi të qëndrueshëm të territorit, që ndërthur vlera kulturore, ekologjike dhe sociale. Në dhjetor 2023, ajo u njoh zyrtarisht si pjesë e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit nga UNESCO, duke theksuar domosdoshmërinë e ruajtjes dhe përshtatjes së saj. Megjithatë, siç evidenton raporti i vlerësimit i realizuar në kuadër të projektit TRUST, kjo praktikë ndodhet sot përballë një krize të shumëfishtë:

- Vetëm 7% e fermave me blegtori të imët në Shqipëri ushtrojnë ende forma të transhumancës, me rreth 400 ferma aktive.

- 70% e veterinerëve të anketuar nga studimi kanë vënë re një rënie të ndjeshme të numrit të barinjve dhe të krerëve të bagëtive që ndjekin praktika shtegtuese, e lidhur drejtpërdrejt me emigrimin, mungesën e të rinjve dhe presionin e klimës.
- Barinjtë të intervistuar në pesë qarqe raportojnë zhvendosje sezonale të kohës së shtegtimit, për shkak të mungesës së burimeve ujore dhe temperaturave ekstreme, duke reduktuar ndjeshëm ciklin tradicional të lëvizjes.
- Po ashtu, është evidentuar mungesë statusi ligjor dhe akses të kufizuar në kullota publike, të cilat shpesh menaxhohen në mënyrë të fragmentuar nga pushteti vendor.

Nga ana veterinare, raporti nxjerr në pah një rritje të rasteve të sëmundjeve, veçanërisht gjatë periudhave të transicionit stinor. Rreth 70% e veterinerëve konfirmuan shtim të sëmundshmërisë për shkak të stresit termik, mungesës së ujit, dhe ndryshimeve në foragjere, ndërkohë që kapacitetet e monitorimit veterinar në terren janë të kufizuara. Përkundër sfidave, studimi nënvizon se transhumanca mbetet një praktikë funksionale dhe e ripërdorshme në kuadër të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Ajo luan një rol kritik në:

- Zhvillimin rural të zonave të thella, ku mungojnë alternativa të qëndrueshme ekonomike,
- Menaxhimin natyror të kullotave dhe peizazhit, përfshirë përhapjen natyrore të lëndëve ushqyese dhe kontrollin e bimësisë,
- Ruajtjen e biodiversitetit dhe rracave autoktone,
- Si dhe forcimin e lidhjes komunitet-natyrë-kulturë, një element thelbësor për politikën e qëndrueshmërisë dhe identitetit rural.

Në këtë kontekst, raporti i studimit evidenton nevojën urgjente për një kuadër të ri institucional, ligjor dhe financiar, që jo vetëm ta mbrojë praktikën e transhumancës si trashëgimi, por ta integrojë atë në mënyrë funksionale në politikën e zhvillimit rural, menaxhimit të territorit, turizmit dhe edukimit mjedisor.

1.3 Burimet e rekomandimeve dhe metodologjia e ndjekur

Rreth hartimit të këtij raporti rekomandimesh është ndjekur një qasje e kombinuar, e mbështetur në evidencë kërkimore dhe procese të strukturuar konsultimi me aktorë të ndryshëm të përfshirë në praktikën e transhumancës në Shqipëri. Rekomandimet e përfshira në këtë dokument janë gjeneruar nga tre burime kryesore:

- Raporti i vlerësimit “Transhumanca në Shqipëri”, i realizuar nga organizata RESU në kuadër të projektit TRUST gjatë periudhës korrik 2024 – prill 2025, i cili përfshiu analizë dokumentare, anketa me 87 veterinerë dhe intervista në terren me 20 barinj në 5 qarqe;
- Procesi konsultativ me komunitetin e barinjve dhe përfaqësues të akademisë, përmes workshopit të organizuar më 28 tetor 2024, i cili solli në vëmendje sfidat konkrete në terren dhe nevojat për mbështetje strukturore;
- Workshopi institucional i organizuar më 23 prill 2025, me praninë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si institucioni i vetëm që finalizoi një set zyrtar rekomandimesh në përgjigje të thirrjes për kontribut.

Metodologjia e ndjekur ka përfshirë:

- Analizë cilësore tematike të të dhënave të mbledhura në raportin e studimit, për të identifikuar sfidat prioritare dhe hapësirat e ndërhyrjes;
- Sistematizim i propozimeve të dala nga workshopet në bazë të aktorëve përgjegjës, me qëllim ndarjen funksionale të rekomandimeve;
- Harmonizim me prioritetet institucionale, përmes përfshirjes së dokumentit “Ide-Rekomandime për Transhumancën” të hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky raport nuk përfaqëson një listë të mbyllur ndërhyrjesh, por një bazë e hapur reflektimi dhe orientimi politik, e ndërtuar mbi një proces gjithëpërfshirës dhe të orientuar nga evidenca. Qasja e ndjekur synon të përforcojë bashkëpunimin ndërsektorial dhe përfshirjen e komuniteteve në vendimmarrje për të garantuar qëndrueshmërinë dhe përshtatjen afatgjatë të praktikës së transhumancës në Shqipëri.

2. Korniza e Aktorëve dhe Roli i tyre

Ruajtja dhe zhvillimi i transhumancës në Shqipëri kërkon një bashkëpunim të gjerë ndërinstitutional, pasi kjo praktikë përfshin jo vetëm sektorin e bujqësisë, por edhe trashëgiminë kulturore, zhvillimin rural, mjedisin dhe shëndetin publik. Aktorët të identifikuar në raportin e vlerësimit përfshijnë:

2.1 Aktorët institucionale

Sipas hartëzimit të realizuar në kuadër të projektit TRUST, institucionet me kompetenca kryesore janë:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) – koordinon politikat për blegtorinë ekstensive dhe ka një rol qendror në menaxhimin e kullotave dhe shërbimeve veterinarë. Përmes strukturave vartëse si AKVMB dhe ISUV, mbulon certifikimin veterinar dhe diagnostikimin e sëmundjeve. MBZHR ishte gjithashtu institucioni i vetëm që, si pjesë e workshopit të datës 23 prill 2025, formalizoi rekomandimet e saj zyrtare për përfshirje në këtë raport.
- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) – përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale. Nëpërmjet saj, Shqipëria ka aplikuar me sukses për njohjen e transhumancës nga UNESCO si trashëgimi botërore.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) – rol konsultativ në lidhjen e praktikës së transhumancës me turizmin rural, zonat e mbrojtura dhe peizazhin kulturor.
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) – luan një rol kyç në zhvillimin e skemave subvencionuese dhe kredive të lehtësuara për barinjtë transhumantë.
- Njësitë e Qeverisjes Vendore – menaxhojnë kullotat publike dhe lëshojnë kontrata sezonaliteti. Ato janë pika kyçe për akses në territor, mirëmbajtje të rrugëve dhe zgjidhjen e konflikteve lokale të tokës.

2.2 Aktorët lokalë dhe komuniteti i barinjve

Barinjtë janë zemra e praktikës së transhumancës, dhe pa praninë e tyre kjo trashëgimi nuk mund të mbijetojë. Ata përfaqësojnë bartësit e dijes tradicionale, rregullave të lëvizjes sezonale, dhe të mënyrës tradicionale të përpunimit të produkteve blegtorale.

Në workshopin e datës 28 tetor 2024, barinjtë evidentuan disa sfida kyçe:

- Mungesën e statusit të qartë ligjor,
- Vështirësitë në akses në kullota dhe ujë,
- Degradimin e shtigjeve tradicionale,
- Mosinformimin mbi mundësitë për përfitime ekonomike apo mbështetje institucionale.

Shumica ndjekin transhumancë vertikale, duke u zhvendosur nga ultësirat në zonat alpine gjatë verës. Ndërkohë, ndryshimet klimatike kanë sjellë zhvendosje sezonale në këtë lëvizje, duke rrezikuar ruajtjen e ciklit natyror të praktikës.

Barinjtë kërkuar zë të drejtpërdrejtë në politikëbërje dhe sugjeruan masa praktike si:

- Akses në burime ujore,
- Infrastrukturë e përmirësuar,
- Mbështetje për ruajtjen e produkteve dhe energji të rinovueshme në stanet malore.

2.3 Roli i Partnereve Kombëtar dhe ndërkombëtarë si dhe shoqërisë civile.

Përveç institucioneve publike dhe komunitetit të barinjve, një rol të pazëvendësueshëm në dokumentimin, mbrojtjen dhe promovimin e transhumancës kanë luajtur organizatat e shoqërisë civile, partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe institucionet akademike. Këta aktorë kanë ndërmarrë iniciativa kërkimore, lobuese dhe ndërgjegjësuere në një kohë kur kjo praktikë nuk ka qenë në prioritetet e agjendës publike.

Organizatat e Shoqërisë Civile si ADAD Malore, GO2 Albania, ANRD, Royal Albania Foundation dhe veçanërisht RESU – Reinforce Sustainability, kanë kontribuar në:

- Dokumentimin dhe mbrojtjen e praktikës baritore në zonat malore,
- Organizimin e workshopeve, aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe studimeve në terren,
- Promovimin e trashëgimisë së gjallë dhe edukimin e komuniteteve për rëndësinë e saj,
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve institucionalë dhe komunitetit.

Partnerët Kombëtarë – si Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka luajtur një rol kyç në procesin e njohjes së transhumancës nga UNESCO si Trashëgimi Kulturor Jomateriale e Njerëzimit. AADF ka ofruar mbështetje financiare dhe teknike për përgatitjen e dosjes së aplikimit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës (MEKI), përfshirë angazhimin e ekspertëve ndërkombëtarë dhe lokalë. Roli i AADF është i lidhur ngushtë me fuqizimin e trashëgimisë kulturore si bazë për zhvillim lokal të qëndrueshëm dhe integrimin e saj në ekonomi.

Partnerët Ndërkombëtarë si Europa Nostra dhe ALIPH Foundation kanë qenë mbështetës të drejtpërdrejtë të projektit TRUST. Përmes fondeve, njohjes dhe përfshirjes së Shqipërisë në rrjetet evropiane të trashëgimisë, ata kanë ndihmuar në ndërkombëtarizimin e kauzës për mbrojtjen e

transhumancës. Kjo ka hapur rrugë për mobilizimin e ekspertizës ndërkombëtare dhe për zhvillimin e instrumenteve për qëndrueshmëri klimatike dhe kulturore.

Akademia dhe Institucionet Kërkimore si Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka zhvilluar konferenca dhe punime shkencore për transhumancën si praktikë kulturore dhe ekologjike. Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti i Tiranës përmenden si aktorë potencialë me rol në fuqizimin e kapaciteteve kërkimore dhe në lidhjen e politikëbërjes me evidencën shkencore. Ndërkohë, bashkëpunimi me universitetet ndërkombëtare mbetet një hapësirë e hapur për kërkime të mëtejshme dhe për zhvillimin e qasjeve të krahasuara.

3. Analiza SWOT e Transhumancës në Shqipëri

Analiza SWOT e realizuar në kuadër të projektit TRUST nxjerr në pah një panoramë të qartë të gjendjes aktuale të praktikës së transhumancës në Shqipëri. Forcat kryesore lidhen me trashëgiminë kulturore të pasur të barinjve shqiptarë, njohjen ndërkombëtare nga UNESCO, dhe kontributin e kësaj praktike në ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin ekologjik të territorit. Kjo përvojë tradicionale përbën një pasuri të rrallë që mbijeton në rajone të veçanta dhe përfaqëson një formë të qëndrueshme bashkëjetese me natyrën.

Megjithatë, dobësitë janë të theksuara dhe kërcënojnë vazhdimësinë e praktikës. Mungesa e një kuadri ligjor të posaçëm, fragmentimi institucional, mungesa e infrastrukturës dhe rënia e interesit tek të rinjtë përbëjnë sfida madhore. Barinjtë përballen me kufizime në akses në kullota, ujë dhe shërbime veterinarë, ndërsa mungesa e një sistemi të dedikuar subvencionesh e vështirëson qëndrueshmërinë ekonomike.

Në anën tjetër, ekzistojnë mundësi konkrete për zhvillim. Përfshirja e transhumancës në turizmin rural, krijimi i etiketave të cilësisë për produktet tradicionale, si dhe mbështetja ndërkombëtare që vjen nga partnerë si UNESCO, Europa Nostra dhe AADF, hapin rrugë të reja për rigjallërimin e praktikës. Po ashtu, digitalizimi dhe rritja e interesit për modelet lokale të zhvillimit qëndrojnë si potenciale të pashfrytëzuara.

Së fundi, kërcënimet më të mëdha lidhen me ndryshimet klimatike, shpopullimin e zonave rurale dhe konkurrencën për përdorimin e tokës. Pa një ndërhyrje të koordinuar, rrezikohet jo vetëm vazhdimësia praktike e transhumancës, por edhe humbja e një trashëgimie të gjallë që ka kontribuar në identitetin dhe ekuilibrin ekologjik të shumë rajoneve në vend.

Analiza SWOT e Transhumancës në Shqipëri

Vlerësim i forcave, dobësi, mundësi dhe kërcënimeve të praktikës baritore shteguese

S - FORCAT (STRENGTHS)

- **Trashëgimi kulturore e gjallë dhe e njohur ndërkombëtarisht**
Transhumanca është shpallur Trashëgimi Jomateriale e Njerëzimit nga UNESCO në vitin 2023, duke krijuar një bazë të fuqishme për mbrojtje institucionale.
- **Përvojë tradicionale e bartur brez pas brezi**
Barinjtë përfaqësojnë një komunitet me njohuri të thella mbi menaxhimin natyror, rracat autoktone dhe territorin.
- **Përhapje në disa rajone me potencial të lartë ekologjik dhe turistik**
Si në Alpet Shqiptare ashtu edhe në zona si Tomorri, Lura dhe Skrapari.
- **Kontribut në biodiversitet dhe peizazh rural të qëndrueshëm**
Transhumanca ndihmon në ruajtjen e bimësisë natyrore, përhapjen e lëndëve ushqyese, dhe balancimin e ekosistemeve kullotore.

W - DOBËSITË (WEAKNESSES)

- **Mungesë e kuadrit ligjor dhe mbështetjes financiare**
Nuk ekziston një ligj specifik për transhumancën dhe nuk ka skema të dedikuara subvencionit për barinjtë.
- **Mungesë akses në kullota, ujë dhe infrastrukturë**
Të dhënat nga barinjtë dhe veterinerët tregojnë se mungesa e burimeve thelbësore është një nga sfidat më të mëdha.
- **Fragmentim ndërinstitucional dhe mungesë koordinimi**
Institucionet veprojnë të ndara dhe shpesh nuk ndajnë të dhëna apo strategji të përbashkëta.
- **Mosinteresimi i të rinjve dhe rënie e numrit të barinjve**
Vetëm 7% e fermave të blegtorisë së imët ndjekin transhumancën dhe trendi është në rënie të ndjeshme.
- **Dobësi në monitorimin shëndetësor të bagëtive**
Veterinerët raportojnë vështirësi në kontrollin e sëmundjeve dhe mungesë koordinimi në periudhat e shtegimit.

O - MUNDËSITË (OPPORTUNITIES)

- **Integrimi në turizmin rural dhe eko-turizëm**
Ka potencial të lartë për të lidhur transhumancën me oferta turistike me karakter kulturor, gastronomik dhe mjedisor.
- **Mbështetje ndërkombëtare dhe fonde të dedikuara**
Njohja nga UNESCO, përfshirja në projekte si TRUST dhe partnerë si Europa Nostra, AADF etj., krijojnë mundësi për mbështetje konkrete.
- **Etiketimi cilësor dhe promovim produkteve tradicionale**
Mundësi për krijimin e markave të mbrojtura të djathit, mishit, leshit dhe produkteve të tjera.
- **Digitalizim dhe promovim përmes platformave të reja**
Mundësi për të dokumentuar dhe promovuar rrugët baritore, për të ofruar eksperiencë për vizitorët dhe forcuar identitetin lokal.

T - KËRCËNIMET (THREATS)

- **Ndryshimet klimatike dhe rritja e ekstremeve**
Thatësitat e zgjatura, mungesa e reshjeve dhe temperaturat ekstreme po ndikojnë direkt në kalendarin dhe ciklin tradicional të lëvizjes.
- **Shpopullimi i zonave rurale dhe plakja e komunitetit baritor**
Mungesa e brezave të rinj që marrin përsipër aktivitetin rrezikon vazhdimësinë.
- **Rritja e sëmundjeve dhe stresit veterinar**
Sëmundjet infektive dhe ngarkesa termike janë në rritje, ndërsa kapacitetet e kontrollit janë të kufizuara.
- **Konfliktet për tokën dhe forma të tjera të përdorimit të territorit**
Zhvillimet turistike intensive apo ndërtimet në zonat e kullotave krijojnë konkurrencë për hapësirë.

4. Rekomandimet Strategjike të Ndara sipas Aktorëve

Fusha	Rekomandimi	Aktorë Kryesorë	Mbështetës të Mundshëm	Afati i Zbatimit
A. Vlerësim & Dokumentim	Realizimi i studimeve antropologjike dhe epidemiologjike për transhumancën	Universitete, ISUV	Shoqëri Civile, Institucione Kulturore	Brenda 1-2 viteve
A. Vlerësim & Dokumentim	Krijimi i regjistrit zyrtar të praktikave dhe dokumentimit vizual	Ministria e Kulturës, IKTK	Shoqëri Civile, Akademia	Brenda 1 viti
A. Vlerësim & Dokumentim	Hartëzimi i shtigjeve dhe kullotave me GIS	MBZHR, MIE	Akademia, Pushteti Vendor	Brenda 2 viteve
A. Vlerësim & Dokumentim	Dokumentimi i produkteve lokale dhe praktikave tradicionale	MBZHR, Ministria e Kulturës	Shoqëri Civile, Agjenci Turizmi	Brenda 2 viteve
A. Vlerësim & Dokumentim	Shpërndarja e informacionit në komunitete lokale	MBZHR	Shoqëri Civile, Pushteti Vendor	Vazhdimisht

A. Vlerësim & Dokumentim	Përfshirja e nxënësve/studentëve në aktivitetet edukative lidhur me transhumancën	MAS, Universitete	Akademia, Institucione Kulturore	Brenda 3 viteve
A. Vlerësim & Dokumentim	Krijimi i një sistemi periodik të vlerësimit të praktikës	MBZHR, AZHBR	Akademia, Shoqëri Civile	Brenda 3 viteve
B. Arsimi & Ndërgjegjësimi	Përfshirja e transhumancës në kurrikulën shkollore	MAS	Akademia, Shoqëri Civile	Brenda 3 viteve
B. Arsimi & Ndërgjegjësimi	Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative mbi transhumancën	MAS, Ministria e Kulturës	Shoqëri Civile, Bashkitë	Vazhdimisht
C. Infrastrukturë & Akses	Përmirësimi i infrastrukturës së rrugëve që përshkohen nga tufat	MBZHR, Bashkitë	MIE, Pushteti Vendor	Brenda 3 viteve
C. Infrastrukturë & Akses	Sigurimi i burimeve ujore dhe energjisë për stanet	MBZHR, AZHBR	Pushteti Vendor, Donatorë	Brenda 2 viteve
Ç. Mbështetje Ekonomike	Subvencione për barinjtë transhumantë dhe fermerët e rinj	MBZHR, AZHBR	Institucione Financiare	Brenda 2 viteve
Ç. Mbështetje Ekonomike	Skema mikrokredie të favorshme për fermerët shtegtues	AZHBR	Partnerë zhvillimi, Shoqëri Mikrofinanciare	Brenda 3 viteve
D. Shëndetësi & Sigurime	Sigurimi i shërbimit shëndetësor për barinjtë dhe familjet e tyre	Ministria e Shëndetësisë	Pushteti Vendor	Brenda 3 viteve
D. Shëndetësi & Sigurime	Mbështetje me sigurime shoqërore të pjesshme për barinjtë shtegtues	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	MBZHR	Brenda 3 viteve
E. Promovim & Trashëgimi	Ngritja e një eko-muzeu për transhumancën	Ministria e Kulturës	Bashkitë, Shoqëri Civile	Brenda 3 viteve
E. Promovim & Trashëgimi	Organizimi i kalendarit të festave tradicionale të lidhura me transhumancën	MEKI, Bashkitë	Shoqëri Civile, Turizëm Lokal	Brenda 2 viteve
F. Kuadër Ligjor & Politika	Hartimi i një ligji për transhumancën ose përfshirja në	MBZHR	Parlamenti, Juristë Ruralë	Brenda 3 viteve

	legjislacionin ekzistues			
F. Kuadër Ligjor & Politika	Hartimi i programeve kombëtare për jetën baritore shtegtuese	MBZHR	Ministritë përkatëse, Bashkitë	Brenda 2 viteve
G. Bashkëpunim Institucional	Krijimi i një mekanizmi ndërinstitucional për transhumancën	MBZHR	MEKI, MTM, AZHBR, MAS	Brenda 1 viti
G. Bashkëpunim Institucional	Harmonizimi i të dhënave midis institucioneve	MBZHR	ISUV, AKVMB, Shoqëri Civile	Brenda 2 viteve

5. Përfundime dhe Hapa të Mëtejshëm

5.1 Nevoja për qasje të integruar ndërsektoriale

Transhumanca është një praktikë që prek një spektër të gjerë fushash – nga bujqësia, mjedisi dhe kultura, te arsimi, turizmi dhe shëndetësia. Kjo shumëdimensionalitet kërkon një qasje të integruar ndërsektoriale, ku institucionet publike të bashkërendojnë kompetencat dhe burimet për të ndërtuar politika koherente dhe mbështetëse. Fragmentimi institucional i evidentuar në raportin e vlerësimit dhe mungesa e një kornize të përbashkët veprimi, mbetet një nga sfidat kyçe që pengon progresin. Ndaj rekomandohet ngritja e një mekanizmi ndërinstitucional bashkërendues, që të përfshijë ministritë përkatëse, pushtetin vendor, përfaqësues të komunitetit baritor, akademinë dhe shoqërinë civile, për të garantuar që zëri i praktikuesve dhe njohuria shkencore të kenë peshë reale në hartimin dhe zbatimin e politikave.

5.3 Nevoja për monitorim dhe reflektim të vazhdueshëm

Qëndrueshmëria e ndërhyrjeve të propozuara varet nga monitorimi i rregullt i progresit dhe nga gatishmëria për reflektim dhe përshtatje në baza të vazhdueshme. Kjo nënkupton:

- Krijimin e një indikatori kombëtar për gjendjen e praktikës së transhumancës, i përfshirë në sistemin statistikor rural.
- Realizimin e vlerësimeve vjetore ose bienale, të cilat mund të udhëhiqen nga MBZHR në bashkëpunim me akademinë dhe OSHC-të.
- Angazhimin e komunitetit të barinjve si pjesë aktive në vlerësim, për të reflektuar realitetin praktik të zbatimit në terren.

Monitorimi nuk duhet të mbetet vetëm një proces teknik, por të shërbejë si bazë për një dialog të hapur politik dhe institucional, ku politika zhvillohet në mënyrë reaktive dhe realiste.